



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TE DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së	NSH Mekanizimi, Prishtinë (“Ndërmarrja”)
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndër. e Re Mekanizimi Ndërtesa Administrative SH.P.K. (“Ndërmarrja Subsidiare”)
Vendndodhja	Prishtinë
Biznesi/Sektori	<p>Historikisht, Ndërmarrja ka qenë furnizues i makinave dhe pajisjeve bujqësore me njësi në tërë Kosovën.</p> <p>Aktualisht, të hyrat kryesore të Ndërmarrjes krijohen nga e ardhura nga qiraja e cila merret nga lëshimi me qira i njësisive të Ndërmarrjes palëve të treta.</p>
Prodhimet	N/A
Tregu	Ndër. e Re me lokacionin e saj strategjik ofron mundësinë për të zhvilluar aktivitete komerciale dhe të qiradhënies.
Konkurrenca	Aktualisht tregu është mjaft konkurrues, pasi që në vitet e fundit në Kosovë ka pasur rritje të konsiderueshme të qiradhënies të pronave dhe aktiviteteve komerciale.
Fuqia punëtore	Asnjë punëtor i Ndërmarrjes nuk do të transferohet në Ndërmarrjen e Re.
Ndërtesat dhe tokat	<p>Ndërmarrja e Re Mekanizimi Ndërtesa Administrative SH.P.K. përfshinë tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 415m² (4 ari, 15 m²) dhe ndërtesën katër katëshe (P+3), e cila në bazë të matjeve në terren përfshinë sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 1,523 m². Ndër. e Re gjendet në një pjesë atraktive të Prishtinës, në rr. Fehmi Agani nr. 39, afër “Kafeve të Vogla”.</p> <p>Dokumenti i vetëm lidhur me pronësinë e tokës, të cilin e posedon AKP-ja është marrëveshja e datës 04/10/1976, e nënshkruar midis Drejtorisë për Ndërtim dhe Rikonstruim në Prishtinë dhe NSH Mekanizimi, në bazë të cilës, NSH Mekanizimit i jepet në shfrytëzim të përhershëm një sipërfaqe prej përafërsisht 415 m² (4 ari, 15 m²) e ngastrës kadastrale 6113/1.</p> <p>Shënim: Toka është në emër të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Duke u bazuar në marrëveshjen e lartcekur, ZR e Prishtinës me datë 18/10/2012 ka bërë kërkesë në Drejtorinë për Kadastër në Prishtinë për azhurnimin e dokumenteve pronësore.</p> <p>AKP-ja posedon vetëm dokumentet e përshkruara më poshtë</p>

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

lidhur me pronësinë e objektit: Vendimin nr. 351-953 i datës 28/12/1976 i lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm i Komunës së Prishtinës, me të cilin i lejohet NSH Mekanizimi ndërtimi i objektit. Gjithashtu posedojmë edhe “Projektin Kryesor” nga Enti për Urbanizëm dhe Projekttime, Prishtinë.

Aktualisht, pjesa më e madhe e objektit (rreth 1,120m²) shfrytëzohet me qira nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe pjesa tjetër shfrytëzohet nga NSH Mekanizimi.

Detyrimet që do të barten:

- (1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (3) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
 - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-se.

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Shikim parcial i Ndër. Re



Informata

Departamenti për Shitje

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet për Ofertë

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Rruga Ilir Konushevcu Nr. 8

10000 Prishtinë/Pristina, Kosovo

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org